REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
ADMINISTRATORI

**Nr. 5648/1 Prot.** **Tiranë më 19.12.2018**

**FTESË PËR OFERTË**

**PËR**
**"BLERJE PAJISJE ELEKTRONIKE"**
me fond limit total= **26, 570 euro pa TVSH**

PROJEKT "ERASMUS+ Programme" (EuroPS)

**Drejtuar: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIK TË INTERESUAR PËR TË MARRË PJESË**

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës - www.unitir.edu.al
Website-n e Fakultetit të Ekonomisë- www.feut.edu.al

Universiteti i Tiranës, në zbatim të "Marrëveshjes së Bashkimit Europian me Qeverinë Shqiptare me ligjin nr.117/2014 për programin e BE-së për Arsimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin, për pjesëmarrjen e R.SH në Programin "ERASMUS+", të Partnership Agreement ndërmjet Koordinatorit Lider Universitetit Novi Sad, Serbi me Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Epoka, për projektin Erasmus+ (K-FORCE) "Knowledge FOr Resilient soCiEty" me numer Ref: 573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP, të Ligjit nr.44, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative në R.Sh*", si dhe mbështetur në Marrëveshjen e bashkëpunimit midis UT dhe U.Epoka, respektivisht me nr.prot. 1987/2, datë 09.05.2018 dhe me nr.prot. 028/3, prot. datë 01.03.2018, Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt **"Blerje pajisje elektronike"**, sipas preventivit të mëposhtëm dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur:

**"Blerje pajisje elektronike për Fakultetin e Ekonomisë të UT", me fond limit = 26,570 euro pa TVSH**

| Nr | Emërtimi i mallrave | Njësia matëse | Sasia (shifra) | Sasia (shkrim) |
|---|---|---|---|---|
| | ***Pajisjet për Universitetin e Tiranës*** | | | |
| 1 | PC kompjuter tip 1 | copë | 31 | tridhjetë e një |
| 2 | Monitor për PC | copë | 31 | tridhjetë e një |
| 3 | Laptop tip 1 | copë | 4 | katër |
| 4 | Projektor tip 1 | copë | 1 | një |
| 5 | Suport Projektori | copë | 1 | një |
| 6 | White Board projektori | copë | 1 | një |
| 7 | Telekomandë për prezantimet WIFI | copë | 1 | një |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8 | Fotokopje/Printer | copë | 1 | një |
| 9 | Grirëse letrash (Shredder) | copë | 1 | një |
| 10 | Router Wireless tip 1 | copë | 1 | një |
| ~~11~~ | ~~Chromecast (transmetues me media streaming)~~ | ~~copë~~ | ~~1~~ | ~~një~~ |
| 12 | Pajisje profesionale Telekonference (Camera + Microphones) Tip 1 | set | 1 | një |
| 13 | Speakers (autoparlant) | copë | 1 | një |
| 14 | Video Converter adapter | copë | 1 | një |
| 15 | Hard disk i jashtëm | copë | 2 | dy |
| 16 | Kamera dixhitale gjysëm profesionale Tip 1 | copë | 1 | një |
| 17 | Suport me tri këmbë për kamera (tripod) | copë | 1 | një |
| 18 | Outdoor Handheld GPS GIS Mapping Data Collector 2-5m | copë | 1 | një |
| 19 | Bojë printeri | copë | 2 | dy |
| | **Çmimi pa TVSH** | | | |
| | **TVSH** | | | |
| | **Vlera me TVSH** | | | |

Data e dorëzimit të ofertës do të jetë **26.12.2018, deri në ora 13:00**, në zarfa të mbyllur të vulosur e firmosur me shënimin për projektin për të cilin ofertojnë, në adresën Rektorati i UT-së, kati 2, Protokolli.

**Kriteret dhe kushtet e ofertës/Terms and conditions of the offer:**

Operatori ekonomik **duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur me shënimin "MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv __________ orës _________", duke specifikuar projektin, objektin e blerjes për të cilin paraqet ofertën ekonomike, pranë autoritetit kontraktor me protokoll, jo më vonë se data dhe ora e caktuar**, dokumentacionin si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

1. Formularin e Ofertës dhe specifikimet teknike të nënshkruara nga OE.
2. Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme sipas Shtojcës këtu bashkëlidhur;
3. Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës këtu bashkëlidhur;
4. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës këtu bashkëlidhur;
5. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare për tre vitet e fundit me vlerë jo më pak se fondi limit për secilin lot ose të dy lotet bashkë kur ofertohet për të dy lotet.
6. Furnizime të ngjashme, vërtetuar nëpërmjet faturave tatimore të shitjes me subjektet private ose vërtetime e fatura tatimore të shitjes për realizim kontratash me subjektet publike, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se 40% i fondit limit.

**Kriteri i vlerësimit/Evaluation criteria:**

- Çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme dhe që përmbush specifikimet teknike.
- Për shpalljen e fituesit, nevojiten jo më pak se 3 oferta të vlefshme, në të kundërt procedura anullohet.
- Dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i realizimit të furnizimit do të jetë brenda **45 ditëve** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Formulari i kontratës është bashkëlidhur.

**ADMINISTRATORI**

**SKERDI DAFA**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza" Rektorati i UT, Tiranë, PO Box nr.183, Tel: +355 4 2228070/Fax: +355 4 2223981

## SPECIFIKIME TEKNIKE DHE SASIA E KËRKUAR

Reference: Projekt Erasmus+ "K-FORCE"
"Knowledge FOr Resilient soCiEty"
me numer Ref: 573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP,

**Objekti: "BLERJE PAJISJE ELEKTRONIKE"**

Për Universitetin e Tiranës / Fakultetin e Ekonomisë, kërkohet furnizimi me mallra, pajisje elektronike, sipas sasisë dhe specifikimeve teknike të mëposhtme ose ekuivalente me to, të cilat duhet të jenë të reja:

**"Blerje pajisje elektronike për Fakultetin e Ekonomisë të UT",**

1. **Desktop + Monitor (Copë 31)**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Pikët Min. përProcesorinsipas: cpubenchmark.net<br>Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | 8000 Pikësipascpu benchmark |
| "RAM": | 4 GB, DDR4, Non-ECC.<br>Suport per deri ne 32GB Ram |
| Madhësia e Hard Diskut "HDD Size": | 500 GB |
| Shpejtësia e Hard Diskut "HDD Speed": | 7200 RPM SATA 6.0 Gb/s |
| "Disk Subsystem Controler": | Serial ATA 6.0 Gb/s |
| Karta Grafike "Graphics": | ≥ 1 GB |
| "Media Device": | DVD+/-RW |
| "Slots": | (4) PCI/PCI-E, ngatëcilat min. (1) PCI-E x16 |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit "Ports": | (8) USB nga të cilat:<br>a. min (2) USB Para<br>b. min (4) USB 3.1<br>(1) RJ-45, (1) Display port, (1) HDMI 1.4. |
| "Networking": | (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port |
| Siguria "Security" | Trusted Platform Module<br>TPM 1.2 or 2.0,Microsoft Windows<br>Bitlocker, |
| SistemiiOperimit "Preinstalled Licensed O. | OEM Windows 10 64-bit Professional |

| | |
|---|---|
| S.": | |
| Tastiera "Keyboard": | Standart Keyboard QWERTY |
| "Mouse": | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| AKSESORËT | |
| Kabëll "Power Cord": | Po, European |
| "Recover CD": | Recover CD/DVD ose Recover Partition |
| MONITORI | |
| Tipi "Type": | LCD OSE LED |
| Madhësia "Size": | > 21" |
| Rezolucioni "Native Resolution": | 1920 x 1080 at 60 Hz , |
| "Display Port": | 1 display port , |
| Koha e Rifreskimit "Response Time": | 8 ms |
| Periudha e mbulimittëgarancisë "Warranty": | 3 vjet |

2. **Laptop Tip 1 (Copë 4)**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Pikët Min. përProcesorinsipas: cpubenchmark.net<br>Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | 4000 |
| "Chipset": | Intel |
| "RAM": | 8 GB, DDR4, Non-ECC |
| Madhësia e Hard Diskut "HDD Size": | 500 GB |
| Shpejtësia e Hard Diskut "HDD Speed": | 7200 RPM SATA |
| "Graphics": | Integrated Graphics with 1 GB Video Memory |
| "Media Device": | DVD+/-RW with DL<br>Memory Card Reader |
| "Display": | 15.6" LED Display, Anti Glare |
| Bateria "Battery": | 47 Wh |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit "Ports": | Min. (3) porta USB ngatëcilat min.<br>(1) USB 3.0<br>(2) DisplayPort Out<br>(3) ose (1) HDMI Out<br>(4) Integrated Mic.<br>(5) Integrated Web Camera<br>(6) (1/1) Headphone/Microphone Jack |

| | |
|---|---|
| | (7) ose Combo Jack<br>(8) 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); "Networking":<br>(9) Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n) |
| "Sound": | High Definition Audio 2.0 |
| SistemiiOperimit "Preinstalled Licensed O. S.": | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| Tastiera "Keyboard": | QWERTY |
| "Pointing Device": | Touch Pad |
| AKSESORËT | |
| Kabëll "Power Cord": | Po, European |
| Ushqyesi "Recharger": | Po |
| "Mouse": | Po |
| Çanta "Carrying Bag": | Po, ngaProdhuesi. E përshtatshmepër Laptop dheAksesorët e tjerë. |
| "Recover" dhe "Drivers" CD/DVD: | "Recover", "Drivers" CD/DVD ose Rec. Partition |
| GARANCIA | |
| Periudha e MbulimittëGarancisë "Warranty": | 3 Vjet |

**3. Projektor: (Copë 1)**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Projection System | Single Chip DLP LVDS |
| Native Resolution | SVGA (800 x 600) |
| Brightness (ANSI Lumens Max.) | 3200 |
| Contrast Ratio | 2200 : 1 Typical (Full On / Full Off) |
| High Contrast Mode | 10000 : 1 |
| Native Resolution | SVGA (800 x 600) |
| Aspect Ratio | 4:3 |
| Projector Lens | F-Stop: F/2.41~2.55 Focal length, f = 21.8~24mm |
| Lens Offset | 115 ±5% |
| Throw Ratio | 1.95 (wide) - 2.15 (tele) |
| Projection Distance | 1.2m ~ 10.0m (3.94 ft ~ 32.81 ft) |
| Keystone Adjustment | Manual Vertical (±40°) |
| Tilt | Front tilt adjustment wheel (-5°~ 5°) |

| | |
|---|---|
| Screen Size - Diagonal | 27.5" ~ 252.4" |
| Colors | 1.07 billion |
| 3D-Capable | Yes |
| Lamp Hours (Light Source Life) | Up to 5K (Nor), Up to 6K (Eco) |
| Audio (Built-in Multimedia Speaker) | 1x 2W |
| Connectivity | |
| Power | 1x AC Power |
| HDMI | 1x HDMI 1.4a |
| Audio In (3.5mm) | 1x Audio-In (3.5mm) |
| Audio-Out (3.5mm) | 1x Audio-Out (3.5mm) |
| VGA In | 1x D-Sub VGA-In |
| VGA-Out | 1x D-Sub VGA-Out |
| Composite Video | 1x Composite Video RCA |
| Powered USB | 1 x Powered USB-A (5V/1.5A) |
| Power Supply | Universal AC 100-240V 50-60Hz with PFC |

4. **Suportprojektori: (Copë 1)**

Mbajtëse Projektori për vendosje në tavan. (Projector Suspension Support). Garancia jo mëpak se 1 vit.

5. **White Board projektori: (Copë 1)**

Tabelë e bardhë për mësimdhënie me dimensione 3.0 x 1.2m, me pajisje montimi të përfshira.

6. **Telekomandë për prezantimet Wifi (Copë 1)**

Telekomandë profesionale për kontrollin e prezantimeve metregueslazer. Receptor USB me rreze 30m. Garancia jo mëpak se 1 vit.

7. **Fotokopje / Printer (Copë 1)**

Shpejtësi e printimit 22 faqe për minutë. Shpejtësi e kopjimit 22 kopje përminutë.
Skanimdheprintimdyfaqesh, me mundësidërgimi me email cloud ose direktori të përbashkëta kompanie.
Rezolucionskanimi - 600x600 dpi Rezolucionprintimi (me ngjyra) – 1800x600 dpi
Memorje – 2 GB
Autonimiprintimipërkartushejo me pak se 20'000 faqe me ngjyradhe jo mëpak se 24000 faqebardh e zi. 2 sirtare letrash ku të suportojnë edhe formate A3 Komandim nëpërmjet monitorit touchscreen (preferueshem10 inch) ku të ketë teknologji konektiviteti të përdoruesve të sigurit (përdorues, fjalëkalim) ose PIN.
Konektiviteti: 2 Hi-Speed USB 2.0 Host; 1 Hi-Speed USB 2.0 Device; 1 Ethernet 10/100 Base-TX network;
2 rezerva boje të përfshira.
Garancia 2 vjet.

8. **Grirëseletrash (Shredder) (Copë 1)**

Makinë grirëse letrash dhe kapseve të tyre, për formatin A4, me kapacitet grirje deri në 6-7 letra njëkohësisht. Me pak zhurmë.

9. **Router Wifi (Copë 1)**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Tipi, "Type": | Router Wireless Wi-Fi Gigabit<br>Wireless router mode |
| "Rating": | Min AC 1900 |
| StandartetWiFi, "WiFi Standards": | IEEE 802.11a/b/g/n/ac |
| Standardet e Rrjetit, "Network Standart": | IEEE 802.11a, IEEE 802.11b, IEEE 802.11g, IEEE 802.11n,<br>IEEE 802.11ac, IPv4, IPv6 |
| Portat, "Ports": | (1) Gigabit WAN Port<br>(2) Gigabit LAN Ports<br>(3) USB 2.0 ose USB 3.0 |
| Llojiilidhjes WAN, "WAN Connection Type": | Automatic IP, Static IP, PPPoE (MPPE supported), PPTP,<br>L2TP |
| NiveliiTransferimit, "Transfer rate": | Min. 300 Mbps |
| Protokollet e Rutimit, "Routing Protocols": | IPSec, L2TP or PPTP |
| Banda e Operimit, "Band": | Dual Band: 2.4 GHz & 5 GHz |
| Antenat, "Antennas": | Build-In or External<br>WEP 64/128-bit |
| Siguria, "Security Features": | WPA2-Personal &Enterpise (AES/TKIP)<br>WPS |
| Periudha e MbulimittëGarancisë "Warranty": | 1 Vit |

**10. Paisje Chromecast (Copë 1)**

Pajisje chromcast për të mundësuar lidhjen wifi me televizore/projektore me dalje HDMI

**11. Pajisje profesionale teleconference - Video conference: (Copë 1)**

Mbulimi me mikrofon 360 °
Ngarkesë mikrofoni deri në 14 foot / 4.2 metra
Shtrirje e thjeshte me mikrofona zgjeruese (me kablloopsionale)
Ideale për dhomat e konferencave të vogla dhe të mesme

Eliminimi I zhurmës së sfondit të mosfunksionimit me Polycom NoiseBlock
Lidhje hibride – Lidhje në ekosisteme të shumta ose në disa telefonata njëkohësisht
Operimi thjeshtuar me prekje me ngjyra min 5"
Integrim me kalendarine Microsoft Exchange per lidhjedirekte
~~Butonat e mbylljes se zerit në secilën ane për funksionim dhe komoditet të thjeshtuar~~
E çertifikuar për Skype për biznes

Bazuar në standard të hapura për të siguruar ndërveprueshmëri me platformat kryesore të hapura SIP dhe video (H.264 AVC, H.264 High Profile, X-H.264UC)

Lidhje e celulare ose laptopëve dhe përdorim Polycom Trio si një altoparlant për konferencat e bazuara në cloud o seri prodhimin multimedial

5-way HD Voice konferencë

Regjistrimi I dyfishtë deri në 2 lidhje (platforma e njëjtë)

**12. Speakers (altoparlant) (Copë 1)**

Altoparlantë të pajisur me:

- Lidhje me Bluetooth
- Lidhje çdo pajisje me hyrje optike dhe hyrje dual RCARMS 24W × 2 + 36 W × 2
- Garancia jo mëpak se 1 vit

**13. Video Converter adapter (Copë 1)**

Konvertues HUB për tipe lidhjesh të ndryshme video HDMI,VGA, Mini HDMI, Mini DP, DVI

**14. Hardisk i jashtem (Copë 1)**

Hardisk I jashtëm HDD 1 TB, USB 3

**15. Kamera dixhitale gjysëmprofesinale (Copë 1)**

18,0 Megapiksel CMOS (APS-C) sensor. Gama ISO e 100-12800(e zgjerueshmenë 25600 në regjimin H), Touch Screen, LenteEF-S 18-55mm f / 3.5-5.6 IS STM. Të përfshirë edhe një SD card 64 GB Klasi 10 SDHC. Model Canon ose ekuivalenti ngjashëm;
Garancia jo mëpak se 1 vit

**16. Suport me trekëmbë për kamera (Tripod) (Copë 1)**

Suport kamere me 3 këmbë që mund të përmbysen dhe të palosen me kënd 180 gradë, Këmbët duhet të ofrojnë lartësi nga 17.5 "derinë 62.5"

**17. Outdoor Handheld GPS GIS Mapping Data Collector 2- 5m: (Copë 1)**
Ofron deri në 1-2 metra saktësi pozicionimi në kohë reale.

Mbështet komponentët GPS (plus GLONASS, GALILEO, oseBeidou) si dhe ka aftësi SBAS për të rritur saktësinë e përmirësuar në kohë reale;

Sistemi operativ Android OS 6.0 "Marshmallow" ose më të larta;

Ekrani madh, I ndritshëm me 5 inç ose më I lartë;

~~Bateritë e zëvendësueshmengapërdoruesitnë standard (3100mAh) ose më të larta;~~

Ekran Multitouch;

Memoria 2 GB ose më e lartë;

Ruajtja e të dhënave 8 GB ose më e lartë;

Procesor - 1.2 GHz ose më i lartë;

Garancia jo mëpak se 1 vit

**18. Bojëprinteri (Copë 2)**

Bojë për printer model Toshiba E-studio200S Model DP-2025

KUJDES: Lutemi të specifikohet marka që do të ofertohet nga ana juaj për secilin zë duke paraqitur mundësisht katalogët përkatës. Kërkohet që karakteristikat kryesore të çdo produkti të jenë të shprehura qartësisht.

[ *Shtojcë nr. 1 për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

Datë / /2018

## FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit: ______________________

Për: **Rektoratin e Universitetit të Tiranës**

**Projekt "K-FORCE"** me nr.ref.: **573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP,**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje pajisje elektronike",** si më poshtë:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është _________ **(vlera në shifra dhe fjalë) Euro pa TVSH;**

**Loti 1 "Blerje pajisje elektronike për Fakultetin e Ekonomisë të UT",**

| **Nr.** | **Emërtimi (përcaktoni markën e ofruar me specifikimet bashkëlidhur)** | **Njësia** | **Sasia** | **Çmimi (pa tvsh) euro** | **Vlera (pa tvsh) euro** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PC kompjuter tip 1 | copë | 31 | | |
| 2 | Monitor për PC | copë | 31 | | |
| 3 | Laptop tip 1 | copë | 4 | | |
| 4 | Projektor tip 1 | copë | 1 | | |
| 5 | Suport Projektori | copë | 1 | | |
| 6 | White Board projektori | copë | 1 | | |
| 7 | Telekomandë për prezantimet Wifi | copë | 1 | | |
| 8 | Fotokopje/Printer | copë | 1 | | |
| 9 | Grirëse letrash (Shredder) | copë | 1 | | |
| 10 | Router Wireless tip 1 | copë | 1 | | |
| 11 | Chromecast (transmetues me media streaming) | copë | 1 | | |
| 12 | Pajisje profesionale telekonference (Camera + Mikrofone) tip 1 | set | 1 | | |
| 13 | Speakers (altoparlant) | copë | 1 | | |
| 14 | Video Converter adapter | copë | 1 | | |
| 15 | Hardisk i jashtëm | copë | 2 | | |
| 16 | Kamera dixhitale gjysëm profesionale tip 1 | copë | 1 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Suport me tre këmbë për kamera (Tripod) | copë | 1 | | |
| 18 | Outdoor Handheld GPS GIS Mapping Data Collector 2-5m | copë | 1 | | |
| 19 | Bojë printeri | copë | 2 | | |
| **Shuma pa TVSH** | | | | | |
| **TVSH (20%)** | | | | | |
| **Vlera Total** | | | | | |

**Emër/Mbiemër/Nënshkrimi i ofertuesit ______________________**
**Vula**

Shënim:

- *Çmimi dhe vlera të shprehen me 2 shifra pas presjes dhjetore.*
- *Konvertimi në Lek në datën e prerjes së faturës, do të bëhet me kursin e këmbimit të Komisionit Europian të muajit në të cilin është bërë financimi i fundit për fondet e pajisjeve në llogaritë e Universitetit, http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/inforeuro/inforeuro_en.cfm.*

**Shtojcë**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

## DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor __________ me objekt __________________me fond limit _________.

Unë i nënshkruari _________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik __________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik ____________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP.

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ___________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik ___________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** ____________

**Nënshkrimi i ofertuesit** _____________

**Vula** _____________

**Shtojcë**

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

## DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë ___.___.**2018** nga Autoriteti Kontraktor **Universiteti i Tiranës**, me objekt ___ **"………………………………"**, me fond limit ________ **euro pa TVSH**, për projektin **Erasmus+ "K-FORCE"** "Knowledge FOr Resilient soCiEty", me numer Ref: 573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP,

Unë i nënshkruari ________________________ me cilësinë e ________________________ të operatorit ekonomik ______________________shpk, deklaroj se:

- Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

- Shpërndarja e sasisë do të jetë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, duke marrë përsipër transportin deri në destinacion (Fakultetin Ekonomise, Universiteti i Tiranës, Rruga e Elbasanit, Tiranë).

Data e dorëzimit të deklaratës: ____________________
Përfaqësuesi i ofertuesit: ____________________
Nënshkrimi:
Vula:

**Shtojcë**

*[Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik]*

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e blerjes që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor______________ me objekt ___________ me fond limit _________.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe

kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik ______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

____________________________

**Vula** ___________________________

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I KONTRATËS**
**MARRËVESHJE/KONTRATË FURNIZIMI**
**OBJEKTI: Blerje pajisje elektronike"**
Projekt Erasmus+ "K-FORCE
"Knowledge FOr Resilient soCiEty"
me numer Ref: 573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP,

***NENI 1***
*PALËT*

1. Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I TIRANËS, përfaqësuar nga ______________________, me adresë Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë.
2. Kontraktuesi: "_______________________" shpk, me administrator Z.__________________, me nr. NIPT-i __________________, me adresë ___________________________________.

***NENI 2***
*TERMAT E KËSAJ MARRËVESHJE*

1. Me "Autoritet Kontraktor" do të kuptohet Universiteti i Tiranës.
2. Me "Kontraktues" do të kuptohet pala që merr përsipër të kryejë furnizimin për Autoritetin Kontraktor.
3. Me "furnizim" do të kuptohet furnizimi me mallra sipas porosisë për UT-FE, të objektit bazuar në Urdhrin e Blerjes nr. __, datë __.__.2018, Ftesën për Ofertë nr. __, datë __.__.2018.
4. Me "Çmim" do të kuptohet çmimi që i paguhet Kontraktuesit në bazë të ofertës së dhënë si dhe sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore, duke përfshirë këtu të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

***NENI 3***
*OBJEKTI*

1. Objekti i kësaj marrëveshje është furnizimi me mallra për objektin "Blerje _____________________", për Universitetin e Tiranës – Fakultetin Ekonomise, si më poshtë, me specifikime sipas aneksit nr.1:

| **Nr** | **Emërtimi i mallit** | **Njësi** | **Sasi** | **Çmimi € pa tvsh** | **Vlera € pa tvsh** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| …… | | | | | |
| 26 | | | | | |
| | **Çmimi pa TVSH** | | | | |
| | **TVSH** | | | | |
| | **Vlera me TVSH** | | | | |

## *NENI 4*
## *AFATI*

1. Afati i kryerjes së furnizimit do të jetë **45 ditëve** nga data e nënshkrimit të kontratës. Me pëlqimin e të dyja palëve kjo marrëveshje mund të zgjatet edhe tej këtij afati nëpërmjet një kërkese me shkrim nga palët për arsye te pergjegjeshme.
2. Kontraktuesi njofton anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, 24 orë përpara me email dhe telefon, për dorëzimin e mallrave në magazinë.
3. Furnizimi me mallra dhe transporti do të bëhet nga furnizuesi, në Universitetin e Tiranës – Fakultetin e Ekonomise, me adresë: Rruga e Elbasanit, Tiranë.
4. Nëse palët do të mendojnë të zgjidhin marrëveshjen duhet të lajmërojnë njëra - tjetrën me shkrim, të paktën 2 ditë para.
5. Zgjidhja e mosmarreveshjeve nuk e çliron Autoritetin Kontraktor nga shlyerja e detyrimeve financiare qe ka ndaj Kontraktuesit.

## *NENI 5*
## *ÇMIMI DHE MËNYRAT E PAGESËS*

1. Çmimi i furnzimit të përcaktuar në objektin e kësaj kontrate do të ketë një vlerë të pergjithshme prej _______ (__________) Euro me tvsh.
2. Pagesa do të kryhet në këtë mënyrë: Pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që lindin nga kjo kontratë, shoqëruar me:
    a. Faturën origjinale tatimore të shitjes së Furnizuesit, që tregon përshkrimin e mallrave, sasinë, çmimin për njësi dhe shumën totale;
    b. Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të mallit.
3. Pagesa do të kryhet në monedhën LEK, në Bankën ___________, në llogarinë bankare nr. _____________, me IBAN _________________________, që Kontraktuesi ka vënë në dispozicion të AK.
4. Konvertimi në Lek në datën e prerjes së faturës, do të bëhet me kursin e këmbimit të Komisionit Europian të muajit në të cilin është bërë financimi i fundit për fondet e pajisjeve në llogarinë e Universitetit, http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/inforeuro/inforeuro_en.cfm.
5. Pagesa si rregull do të bëhet, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës nga kontraktuesi.

## *NENI 6*
## SIGURIMI I KONTRATËS DHE GARANCIA

1. Kontraktuesi duhet te paraqese Sigurimin e Kontrates në shumën prej *(10% të cmimit te kontrates)* për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit me përfundimin e plote të kontratës.
2. Garancia: Mallrat e ofruar duhet të mbulohen nga garancia jo më pak se 12 muaj nga data e lëvrimit tek AK, apo më shumë në varësi të specifikimeve teknike të Aneksit nr. 1.

## *NENI 7*
## *TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE*

1. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë korrektësi dhe përmbushje të detyrave brenda afateve të caktuar nga palët në këtë kontratë.
2. Autoriteti Kontraktor detyrohet të paguajë vlerën e furnizimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj kontrate pa qenë nevoja e lajmërimit më përpara nga Porositësi.

3. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë informacion të plotë mbi të gjitha detyrat që i kërkohen.
4. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë vlerën e furnizimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontrate.
5. Kontraktuesi detyrohet të kryejë me besnikëri dhe korrektësi të gjitha detyrat e përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të kësaj kontrate, duke iu përmbajtur afateve të përcaktuara dhe specifikimeve teknike të Aneksit nr.1.

***NENI 8***
*RUAJTJA E SEKRETIT*

1. Të dyja palët angazhohen në ruajtjen e sekretit profesional për probleme të cilat kanë lidhje me objektin e kësaj marrëveshje. Të dyja palët angazhohen të respektojnë njëri-tjetrin maksimalisht dhe të përmbushin detyrat e marra përsipër.

***NENI 9***
FORCAT MADHORE

1. Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjes për penalitete ose ndërprerje kontrate për mos përmbushje të furnizimit në qoftë se kjo vonese në performancën ose mospërmbushje e detyrimeve sipas Kontratës vjen si rezultat i një ngjarje që është Forcë Madhore dhe deri në masën që ajo e shkakton mospërmbushjen.
2. Për qëllimet e kësaj klauzole, "Force Madhore" do të thotë një ngjarje përtej kontrollit të Furnizuesit dhe që nuk përfshin fajin e Furnizuesit apo neglizhencën dhe që është e paparashikueshme. Këto ngjarje mund te përfshihen por mund te mos kufizohen vetëm me një akt të AK ne kapacitetin e tij sovran, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë, kufizimet e karantinës, dhe embargo te ngarkesës.
3. Në qofte se lind situata e një Force Madhore, Furnizuesi do të njoftojë menjëherë AK me shkrim për këto kushte dhe shkakun që e ka sjelle atë. Vetëm në qoftë se udhëzohet ndryshe nga AK me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë të kryejë detyrimet e tij sipas Kontratës për aq sa është praktike në mënyre të arsyeshme, dhe do të kërkoj të gjitha mjetet alternative të arsyeshme për performancën të pa penguara nga ngjarja e Forcës Madhore.

***NENI 10***
*ZGJIDHJA E MARRËVESHJES*

1. Marrëveshja përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar.
2. Marrëveshja mund të zgjidhet edhe para mbarimit të ketij afati me pëlqimin e të dyja palëve pasi të kenë ezauruar detyrimet reciproke.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila palë duke lajmëruar të paktën 2 ditë para.
4. Marrëveshja mund të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor nëse Kontrakuesi nuk përmbush detyrimet e percaktuara ne nenin 1, nenin 3, nenin 4, nenin 6 dhe nenin 8.

***NENI 11***
*ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE*

1. Çdo interpretim i termave do të merret në favor të dyja palëve dhe në kuptimin e përdorshëm të tyre në standardet normale.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje.

| | |
|---|---|
| **AUTORITET KONTRAKTOR** | **KONTRAKTUESI** |
| **UNIVERSITETI I TIRANËS** | "____________________" |
| **ADMINISTRATORI** | **ADMINISTRATORI** |